Lezhë, më 28.09.2023

# PROCES VERBAL

- I mbajtur sot, në datën 28.09.2023, në orën 12:00, në sallën e Bibliotekës "At' Gjergj Fishta" Lezhë, mbi mbledhjen e radhës për muajin Shtator 2023, të këshillit të Bashkisë Lezhë.
- Mbledhja u hap nga Kryetari z. Ndue Luli i cili lexoi rendin e ditës dhe dy pikat shtesë.
- Kryetari hodhi në votim rendin e ditës që u miratua nga të gjithë këshilltarët prezentë.
- Erdhi këshilltarja Alfrida Marku.
- Ndue Luli - Fillojmë me projekt-vendimin e parë "Për dhënien e mandatit si anëtare e këshillit të Bashkisë Lezhë znj. Adeline Tome".
  Fjalën e ka kryetari i komisionit të Mandateve.
- Klejvi Hoxhiqi: - Komisioni i Mandateve, Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike u mblodh dje dt: 27.09.2023. Shqyrtuam dhënien e mandatit si anëtare e K.B. Lezhë znj. Adeline Tome. Pasi shqyrtuam dokumentacionin vendosëm mosdhënien e mandatit si propozim për këshillin sepse znj. Adeline Tome ka refuzuar me anë të një deklarate noteriale marrjen e mandatit.
- Ndue Luli - Atëherë kush është dakord për mosdhënien e mandatit znj. Adeline Tome. Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç znj. Alfrida Marku që nuk votoi.
  Vazhdojmë me projekt vendimin e dytë "Për dhënien e mandatit si anëtare e këshillit të

Bashkisë Lezhë znj. Vera Dede".
Fjalën e ka Komisioni i Mandateve.
Klejvi Hoxhiqi – Është e njëjta gjë për këtë rast, por dhe për rastin tjetër që vijon, që mos të zgjatemi shumë. E kanë refuzuar marrjen e mandatit me anë të deklaratave noteriale dhe në bazë shqyrtimit dokumentacionit vendosëm t'i propozojmë këshillit mosdhënien e mandateve.
Ndue Luli: Kush është dakord për mosdhënien e mandatit znj. Vera Dede?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç znj. Alfride Marku që nuk votoi.
Po kështu dhe për zonjën tjetër Flora Margjonaj, Kush është dakord për mosdhënien e mandatit?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç znj. Alfride Marku që nuk votoi.
Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Gusht 2023".
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Alfride Marku që nuk votoi.
Vazhdojmë me pikën 5 të rendit të ditës që është projekt vendim "Për një ndryshim në Vendimin e KB nr. 120, datë 02.12.2022 "Për

miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023" dhe përdorim të fondit të kontingjencës".

Fjalën e ka komisioni i Financës.

Agostin Marku: Komisioni i Financës është dakord me këtë projekt vendim, pavarësisht se nga aparati i bashkisë nuk u perceptua asnjë person në mbledhjen e komisionit. Ne e çmojmë të arsyeshme ta miratojmë sepse rrjedh nga një vendim që është marrë në mbledhjen tjetër të K. Bashkiak dhe ka të bëjë me një shtesë organike për 3 punonjës në çerdhe. Baza ligjore është në rregull, fondet janë të siguruara dhe i propozojmë këshillit që ta miratojmë këtë p/vendim.

Donika Nolaj: Në lidhje me punësimin e këtyre 3 zonjave, në fakt mua po më vjen mirë që në çerdhe ka një numër të rritur të fëmijëve duke pasë se vuajnë shkollat e kopshtet për nxënës. Shpresoj që këto të mos jenë punësime apo premtime elektorale. Shpresoj të jetë rritur vërtet numri i fëmijëve që shkojnë në çerdhe dhe së dyti, pashë që miratohen vetëm për 3 muaj. A do jenë me kohë të pjesshme apo do të miratohen përsëri?

Ndue Luli: Z. nënkryetar keni fjalën.

Ermal Pacaj: Bëhet fjalë për shtesën sipas nevojave në çerdhen në qendër të qytetit, që

në fakt ishte një investim që ishte parashikuar që në buxhetin e vitit 2023. Më parë ishin vetëm tre ambiente funksionale. Rikonstruksioni bëri që të rritet kapaciteti, pra nuk është çështje premtimi elektoral. Në kodin e Punës 3 muaj është periudha e provës.

Ndue Luli: Meqë nuk ka mendime të tjera e kalojmë në votim. Kush është dakord?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë përveç z. Rrok Marku dhe znj. Alfrida Marku që nuk votuan.

Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e PBA-së 2024-2026 të Bashkisë Lezhë (Faza e Dytë)".

Fjalën e ka kryetari i Komisionit të Financës.

Agostin Marku: Komisioni nuk shprehet dot për këtë projekt vendim sepse ne kishim shumë nevojë të sqarohemi nga administrata e bashkisë dhe realisht nuk ka qenë prezent dje, kështu që ne e shtyjmë për ta diskutuar dhe për të bërë debatin në këshill, nga çdo këshilltar me pyetje e sugjerime, pasi nuk është ezauruar fare në mbledhjen e komisionit.

Alfrida Marku: Para se të kalojmë në diskutimin e PBA-së, unë dua të denoncoj publikisht një sjellje antiligjore që prekon qytetarët e Lezhës, nga ana e këshillit të Bashkisë Lezhë.

Ndue Luli: Të ndërpres fjalën për kalimin nga rendi i ditës. Te "Të ndryshme" fol.

Alfride Marku: Nuk ma ndërpret dot fjalën. Jep llogari se pse banorëve të Lezhës iu refuzohet mundësia të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit, kur ato janë publike

Ndue Luli: Te pika "Të ndryshme" do sqaroj jo vetëm ty, por gjithë këshilltarët dhe qytetarët. Kjo tregon se ti si këshilltare nuk e njeh rregulloren për marrjen pjesë të qytetarëve në mbledhjet e këshillit. Hape, lexoje nenin 38.

Alfride Marku: Lexo ligjin "Për Vetëqeverisjen Vendore". Mbledhjet e këshillit janë publike. Në lidhje me projekt vendimin, një pyetje të thjeshtë kam unë - Sa dëgjesa publike, të detyrueshme, sipas parashikimeve në ligjin "Për Vetëqeverisjen Vendore", ka zhvilluar Bashkia Lezhë dhe ky institucion? A keni zhvilluar një dëgjesë të vetme publike për të marrë prioritetet e banorëve të Bashkisë Lezhë?

Ndue Luli: Mbaro me pyetjet.

Alfride Marku: Vazhdojmë me përgjigjen e pyetjes së parë.

Agostin Marku: Znj. këshilltare, kam edhe unë pyetje. Vazhdojmë me pyetje, kush ka pyetje, pastaj fillojmë me diskutimet.

Nuk po ta mohon askush përgjigjen e pyetjes.

Alfride Marku: Unë mendoj që të gjithë përfaqësuesit e opozitës këtu, fillimisht kërkojnë këtë përgjigje.
Agostin Marku: Unë kam një pyetje. Faza e dytë e PBA-së 2024-2026 ka ndryshim material me fazën e parë? Pyetje e dytë – (do i kisha bërë në mbledhje të komisionit, s'kam pasë kujt t'ia drejtoj dhe i ngre në këshill) – Tek viti 2023 kemi dy kolona, plani i buxhetit dhe i pritshmi, është njëlloj si në fazën e parë dhe në fazën e dytë dhe i pritshmi është njëlloj me planin. Si do ta kuptojmë këtë të pritshmin e vitit 2023?
Ndue Luli: Pyetje të tjera.
Pjetër Tushaj: Në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve në mbledhje – Se është mundësia, se këtu mund të vijnë 50 vetë, 100 vetë. Se ditë përpara duhet njoftuar se edhe mua më kanë thënë që duan të vijnë.
Ndue Luli: Ke shumë të drejtë, por thashë në fillim për këtë problematikë do ta sqaroj te pika të ndryshme. Nuk do dalë askush i pasqaruar.
Ka pyetje të tjera në lidhje me pikën e rendit të ditës?
Flutura Gjoni: Pyetja është pak e zgjeruar. Na është sjellë Faza e Dytë e PBA-së

2024 - 2026. Unë i kam lexuar të dyja, edhe fazën e dytë, edhe fazën e parë, është copy-paste, pa asnjë ndryshim, edhe gabimet ortografike janë identike. Unë, në diskutimin e fazës së parë vura theksin për Lezhën e dimë si e ka punën e përmbytjes. Hartimi i planit studimor antipërmbytje është në vitin 2026 kur ka prioritet ky studim që e keni çuar në vitin 2026? E njëjta gjë me këtë është dhe pritat malore, në 2026. Të gjitha këto, unë që jam e zonakit, shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet. Kaq.

Ndue Luli: Vazhdojmë me pyetje të tjera.

Dod Joku: Unë mendoj që të shtyhet për një fazë tjetër mepë dhe komisioni nuk e ka marrë në shqyrtim.

Ndue Luli: Pyetje tjetër ka?

Atëherë kalojmë te përgjigjet e pyetjeve

2. Nënkryetar.

Esmal Paca: Faleminderit kryetar.

Për sa i përket shqyrtimit të projektit buxhetit do të filloj me një ndjesë ndaj këshillit në qoftë se Drejtoria e Financës nuk është paraqitur, ndoshta për disakordancë oraresh, gjithsesi kjo është një gjë për të cilën duhet reflektuar nga administrata e bashkisë, por arsyeja dihet, - i ka ndodhur një problematikë drejtuesit atij dhe besoj se kjo ka qenë arsyeja. Kjo është për pjesën e mosmarrjes pjesë në komisione. Në lidhje me pjesën tjetër,

unë i mbajta shënim pyetjet, pavarësisht se pyetja
e parë zgjati 100 vjet. Këshilli i Bashkisë nuk
është një arenë ku duhet të shkëlqejë personazhe
individuale. por vend ku duhet të transmetohen
problemet e qytetarëve. Më vjen shumë keq që
mbledhje pas mbledhje kjo gjë nuk po reflektohet.
megjithatë është pak e rëndësishme. Është plani
personal i fituesit këtu. Sa i përket pyetjes
së zj. Gjoni, Bashkia e Lezhës e ka në vëmendje
problemin e përmbytjes. Krahasuar me vitin 2019, kemi
një rënie me 20% të zonave të përmbytura. Në
zonën e Dajçit dhe të Torovicës që kanë qenë zonat
më problematike, ku për shkak të heqjes së
kanaleve të dyta e të treta, ka patur impakt të
jashtëzakonshëm. Jemi në një pikë që nuk mund të marrim
shumë lekë nga buxheti dhe t'i çojmë në një kauzë
ku përditë kemi dhënë zgjidhje dhe po gjejmë zgjidhje.
Rrjeti i kanaleve kulluese është optimal në Bashkinë
e Lezhës. Ka problematika që kushtëzojnë por që janë
përpara planit. Është parë e arsyeshme që një pjesë
fondi të çohet atje ku ka më shumë nevojë. Pra,
më nevojë për momentin ka heqje e kanaleve ekzistuese.
pastaj për të zgjeruar rrjetin, për të parë se ku janë
pikat më vulnerabël etj. E njëjta gjë është
dhe për pritat malore. Pavarësisht se nuk kemi
plan, projekte ka për pritat malore. dhe në
buxhetin që do vijë, kemi parashikuar prita malore

në Kallmet, në Zejmen, në Ungrej. Sipas ligjit jemi të detyruar të parashikojmë fondin prej 4% për emergjencat civile, gjithashtu është dhe fondi i kontingjencës për përdoret në këto raste. Pra, kjo gjë është nën kontroll, pra nuk është fare problem se çfarë plani është parashikuar për vitin 2026.
Besoj se isha shterues në përgjigjen time.
Sa i përket asaj që përmendi z. Agostin, në lidhje me komisionin, a mund të flasë Xhemali?
- Erdhi këshilltari Edlir Reçi.
- Xhemal Hoxhia: Së pari, faza e parë është miratuar nga këshilli. Kanë ardhur tavanet për nga faza e parë në fazën e dytë nuk kemë asnjë lloj ndryshimi. Kjo fazë është teknike edhe në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Financave. Do reflektohen më tej edhe ndryshimet për do vijnë nga drejtësat, por edhe nga këshilli.
I pritshmi nuk ka pasë ndryshime për 7 mujorin.
- Ndue Luli: Faleminderit. Vazhdojmë me diskutimet.
- Alfrida Marku: Se si mund të gjenë projektet në plan, vetëm Bashkia lektoi vjen dhe ia përcjell këshillit. Kur projektet gjenë në plan dhe pretendohet për PBA të kalohet pa u konsultuar me banorët, kjo është për të ardhë kap.
- Ndue Luli: Diskutim tjetër kush ka?
- Sovejan Kosova: Si përfaqësues i Zonës së Torovicës e Balldrenit, e vë në dijeni zotin nënkryetar se për pjesën e përmbytjeve nuk ka asnjë lloj ndryshimi, jo se e ka

ti në dorë por propagandë nuk është e mirë dhe biseda se është bërë kjo apo është bërë ajo pa asnjë foto, shifra, besoj se nuk i përket këtij institucioni. Dikur Dobrovica përmbytej edhe në maj, tani përmbytet në prill. Këtë arsyetim ia lejojmë zotit nënkryetar, unë besoj që pjesa e përmbytjes duhet të analizohet dhe plani duhet të afrohet. Kjo pjesë është e rëndësishme për fitimin territorit dhe besoj që duhet ta rimarrni në konsideratë.

- Ermal Pacaj: Në përgjigje të asaj që tha z. Kosova, ideja e tij përballë times është nonsens sepse e thotë që diçka jo të vërtetë. Unë i kam shifrat të gjitha për pyetjen, zonën e Zadrimës, Dobrovicës.
Mund të thërrisni në interpelancë Drejtorinë e Bujqësisë dhe Drejtorinë e Emergjencave që të vijnë me shifra. Nuk është në standartin e këshillit të diskutohet kështu.
- Sokol Kosova: Z. nënkryetar, unë te dhashë medaljen e asaj që ke bërë. Në momentin që thua thërrisni drejtoritë në interpelancë, dmth që ti nuk ke asnjë bazë ku ta mbështetësh debatin. Thelbi i asaj që thashë unë ishte që t'i jepet vëmendje planit.
- Noke Luli: Mendim tjetër?
- Donika Hoxhia: Cilat janë projektet në plan për të shpëtuar nga përmbytjet pranë shkollës "KOSOVA". Nëse do bëhet një plan për vitin 2026, në një kuptim që është shumë vonë. E njëjta situatë është edhe te shkolla "Gjergj Fishta". Unë nuk dyshoj te shifrat

tuaje, me shifrat mund të jemi shumë në rregull.
Ne jemi këtu për të thënë edhe problematikat që na thonë të tjerët
Lagjja e pazarit është pjesë e qytetit. Kur është bërë ndërhyrje atij

- z. Ndue Luli bëri një sqarim për këshilltarët në lidhje me pyetjen e pyetjen dhe të diskutimeve dhe i dha fjalën zv/kryetarit të Bashkisë z. Paçaj i cili dha një sqarim në lidhje me termin e përdorur më lart "projekt pa plan", si dhe në lidhje me dy shkollat tha që është projekti i KFW gjerman që është në pritje të implementimit në janar 2024, ndërsa për te pazari tha që janë bërë ndërhyrje por sipas specialistëve është nën nivelin e kullimit dhe që do ketë një projekt në buxhet për zgjidhjen e atij problemi.
- Ndue Luli i ka dikush tjetër diskutim në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës?
- Agostin Marku: Sa i takon çështjes së prezencës së aparatit të bashkisë në mbledhjen e komisionit, nuk ka pasë seriozitet i duhur i gjithë aparatit sepse nuk është thjeshtë çështje e ardhjes së drejtorit të Financës, apo e një specialisti të financës. Ky është një projekt vendim që duhet të ishin të gjitha drejtoritë përkatëse. Mosfunksionimi i diskutimit në komisione bën që mbledhje të shkojë më gjatë. Funksionimi bën që ne të marrim vendime shumë më cilësore. Sa i

takon çështjes së ndryshimeve, nuk është serioze që të na vijë e njëjta si faza e parë, si faza e dytë. Pse ndodhin këto? Ndodhin tha në atë shpejtësim që ka Këshilli. Duhet ta pranojmë. Edhe dëgjesat publike nuk bëhen si duhet. Nuk duhet të justifikohemi me atë që jo duhet t'i bëjë Këshilli, jo bashkia. Më i interesuar për të bërë dëgjesat publike duhet të jetë aparati i bashkisë. Këtë radhë po ia lemë vitit zgjedhor por ato ndikojnë në marrjen më të mirë të problematikave, dhe në komunikim me njësitë administrative, me specialistët, do bëjnë punën e duhur.
Sa i përket planit 2023 dhe të pritshmit 2023. Ne si këshilltarë, pak më shumë ne të fushës, e dimë shumë mirë ç'do të thotë plan. Plani është në rregull, por të shumojmë sot të pritshmin njëlloj si planin, kjo është e pafalshme, se aktualisht të del i pritshmi më i lartë se plani. Po të shohim raportin e zbatimit të buxhetit për 7-mujorin, i ka të ardhurat 48%, kurse shpenzimet 67%. Nuk është problemi të bëjmë letra kot sa për t'i çuar në Ministrinë e financave për të realizuar afatet.
Po e pranojmë ne se kjo është diçka formale deri kur të vijë faza përfundimtare. Më vjen mirë për diçka, që është te ky material, që unë e kam kërkuar 4 vitet e kaluara që nuk ka qenë; përfshirje e Ujësjellës-Kanalizime në anekset e buxhetit.
Të kemi një vëmendje më të madhe ndaj projektvendimeve

që sillni në këshill, ndaj propozitës në komisionere
Unë i propozoj këshillit, duke qenë se ky p/vendim
ka më tepër karakter formal për çështje të plotësimit
të ca afatere, kemi dhe fazën e tretë të diskutimit
të kësaj çështje dhe kur të përgatitet buxheti 2024,
këto që diskutuam sot të reflektohen, por ç'është
më e rëndësishmja dëgjesat publike duke propozuar
në radhë të parë një buxhet që i shërben në radhë
të parë komunitetit, prandaj propozoj që ta miratojmë.

- Ermal Paçi: Në kuadrin e asaj që tha z. Marku,
prioritetet janë prioritete. Nuk ndryshojnë edhe për
5 vite, megjithatë ai thotë ashtu. Sa i përket pjesës
së konsultimeve, Bashkia Lezhë nuk ka bërë ndonjëherë
për 4 vite Buxhet apo Paketë Fiskale pa u konsultuar
me qytetarët apo grupet e interesit. Se i bëjmë
në ftesë njerëzve për të ardhur dhe njerëzit nuk vijnë
se diku ka e kanë politikisht apo arsye tjetër, por
Bashkia e Lezhës i ka të publikuara në web
të gjitha. Edhe nëse nuk janë bërë të hapura
sepse ligji zgjedhor nuk e lejon, ato janë bërë
on-line nëpërmjet një sondazhi të zhvilluar

- Agostin Marku: Unë nuk thashë që nuk bëhen, por që
të jenë sa më funksionale. Ti je sqarëtar, por nuk
është këshilli me sqarë. Unë nuk kam qenë te asnjëra
dhe nuk kam shkelur ligjin. Unë thjesht kam bërë
vërejtje se thjesht dua të mirën, se jam pjesë e
maxhorancës. E përsëris, rregullojini ato gjëra se thjesht

duhen në radhë të parë juve.

- Ndue Luli: Kam bindjen e plotë që secili që e dëgjoi fjalën e z/kryetarit është i gatshëm për të gjitha problemet që u ngritën

Kush është dakord që për këtë fazë, ky p/vendim, ashtu siç ka ardhur të kalojë dhe të zbatohet për fazën e tretë çdo gjë që i takon këtij p/vendimi?

Votuan Pro 22 këshilltarë, votuan kundër 4 këshilltarë: Sarajçin Kosova, Alfride Marku, Donika Hoxhia, Flutura Gjoni dhe abstenim Emanuel Pëgjeka.

Kalojmë te projekt vendimi shtesë "Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK"

- Agostin Marku: kemi dy lloj procedurash për privatizimin. Janë raste që për arsye të ndryshme nuk i kanë bërë në kohën e duhur procedurat e privatizimit. Hipoteka kërkon një vendim nga organi vendimmarrës i Bashkisë që është këshilli. Kjo është një procedurë pothuajse formale për ne, që mos të pengohen qytetarët. Ka ca vendime të tjera pastaj që kanë të bëjnë me privatizime e trashëgime që kërkojnë vëmendjen e duhur. Ky rast thjesht ka të bëjë me një qytetar për legalizimin e asaj që ka marrë në vitet '90. Thjesht atë shtëpi që ka jetuar për 50 vjet do e bëjë me letra, do e bëjë me hipotekë.

- Kush është dakord me projekt vendimin?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e Planit Tematik Vjetor të Këshillit të Bashkisë Lezhë për vitin 2024".
Secili nga ne e ka marrë këtë draft. Për arsye të ndryshme ndodh që planet të kërkojnë ndryshim, ne këtu jemi. Kush ka diçka?

- Donika Ndoj: Në muajin mars nuk ka diçka për festën e mësuesit 7-Marsin, por edhe për ditën e gruas, 8-Marsin, konkretisht.

- Agostin Marku: Ideja ka qenë si fillim që ne të bëjmë një plan tematik si këshill, më shumë që të orientohemi dhe mos të mbesim vetëm në ato vendimmarrjet e momentit që na sjell bashkia, por të angazhohemi me të gjitha institucionet por dhe me aktivitetet që mund të bëhen gjatë 12 muajve të vitit në territorin e Bashkisë Lezhë. Këshilli është autoriteti atje ku shohim shqetësimet e komunitetit. Nuk është diçka e përkryer. Gjatë kohës mund të bëjmë rregullime. Bëje propozimin si mund ta formulojmë dhe e ndryshojmë atje Donika dhe ta miratojmë me atë ndryshim që propozoni ju. N.q.s ka dikush tjetër propozime të tjera, kujdes t'i shtojmë në mënyrë që plani të jetë sa më gjithëpërfshirës.

- Dod Jaku: Në lidhje me tematikat e vitit të ardhshëm ka gjithëpërfshirje por unë mendoj të shtohet çështja e energjisë elektrike, çështja e turizmit, diçka në lidhje me biznesin e vogël e

të mesëm si dhe në lidhje me problemet Sociale.

- Ndue Luli: Kush është dakord që Planin Tematik të këshillit ta miratojmë me shtesat e propozuara nga znj. Ndoj dhe z. Jaku?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç një vote abstenim nga znj. Alfrida Marku.

- Kalojmë te pika 8 që është projekt vendim "Për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë dhe të kryetarëve të fshatrave si dhe miratimin e pagave për çdo fshat në Bashkinë Lezhë".

Kush ka diçka?

- Alfrida Marku: Ky projektvendim, siç e kam ngritur edhe në mbledhjen e kryesisë së këshillit, i hap rrugë një procesi të padrejtë. sepse komisionet e Monitorimit të procesit përbëhen nga një shumicë të përbërë nga përfaqësuesit e bashkisë dhe nga këshilli të anëtarëve të Partisë Socialiste dhe Partive të tjera në aleancë me të. (1+2) Kuptohet që me shumicë votash ky komision ka tagër të zgjedhë dhe komisionin e Votimit, pra fitorja është e paracaktuar. Ju po përpiqeni t'i shërbeni interesave tuaja politike duke cënuar një hallkë shumë të rëndësishme midis bashkisë dhe qytetarëve. Unë propozoj që për të shmangur këtë përpjekje abuzive, komisionet mos të jenë kuota politike, mos të jenë përfaqësuesit e bashkisë.

Ndue Luli: ky projekt vendim është përgatitur

duke u bazuar te rregulloren që kemi miratuar
së bashku në këtë këshill, para rreth 2 muajsh, ku
thuhet shprehimisht se komisioni përbëhet nga:
2 këshilltarë të pozitës, 2 këshilltarë të opozitës
dhe kryetari i njësisë administrative i cili ka dhe
rolin për njoftimin e banorëve. Pra e theksoj,
kemi zbatuar rregulloren. Sa i përket komisionit
të votimit që thua që ndikon. Çdo lagje ka të
drejtë nëpërmjet banorëve të lagjes, të zgjedhë
komisionin vetë ata. Komisioni që fillon nga ora
ka vetëm rol monitorues në këtë rast. Sa i përket
marrëveshjeve të tjera, këtu nuk ka marrëveshje,
ka vendime. Besoj se jam i qartë.

Pjetër Tushaj: Një sqarim desha. Emrat kush
i cakton.

Ndue Luli: Emrat, propozimet vijnë nga
komuniteti i lagjes. Nëse p.sh. fshati ka 5 lagje,
në çdo lagje bëhen zgjedhje ku komisioni i votimit
zgjidhet nga banorë të vetë lagjes dhe secili fitues
në lagje është anëtar i kryesisë së fshatit.
Këta të pestë mblidhen dhe votojnë për të zgjedhur
midis të pestëve kryetarin e fshatit. Pra komisioni
është monitorues i zgjedhjeve të kryetarëve të fshatrave.
Të bindemi për këtë.

Alfride Marku: Sipas pikës 11 të p/vendimit,
komisioni i Monitorimit nuk është vetëm me tagër
monitorimi por kryen rolin edhe të komisionit

zgjedhor në zgjedhjen e kryetarit të fshatit, edhe me tager për organizimin e procesit.

- Agostin Marku: Të them dhe unë një dy gjëra sqaruese ngaqë kam qenë pjesë e hartimit të këtij p/vendimi i cili është hartuar 100% mbi bazën e ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe rregulloren që kemi miratuar të gjithë sëbashku me votë unanime në datën 30 gusht me nr. vendimi 39. Gjithçka është e përcaktuar në atë rregullore. E reja e kësaj është që nga data e miratimit lihet një muaj kohë për sensibilizimin e gjithë faktorëve që përfshihen në këtë vendim dhe atyre që janë të interesuar të bëhen pjesë e procesit për këtë vendim, pra nuk e miratojmë vendimin sot e fillojmë nesër. dhe çdo anëtar që futet në garë ka ca kritere që janë në rregullore, nuk janë në vendim. Komisioni - nuk janë 2 të PS-së e 2 të PD-së por janë 2 të pozitës e 2 të opozitës dhe është përfshirë dhe administratori sepse ka peshën kryesore për sa i përket infrastrukturës. Ky p/vendim është i bazuar në ligj sa i përket edhe ndarjes së lagjeve, që është koncept i futur dhe në rregullore, komisioni i votimit do zgjidhet nga vetë banorët e lagjes, pra s'ka punë Komisioni i Monitorimit në çështjen e marrjes pjesë në votim, është sikur anëtarët e komisionit të lagjes propozohen nga vetë banorët, komisioni i Monitorimit ka cilësinë e komisionit të votimit vetëm në zgjedhjen e kryetarit të Fshatit. Duam të bëjmë politikë e s'dimë. Kush

do fitë komisioni po s'pe komisioni i Monitorimit? Ky e ke ndikimin ky kur ata për kanë dalë të zgjedhur nëpër lagje mblidhen për të zgjedhur kryetarin e fshatit? Janë përcaktuar datat për përveç Komisionit të Monitorimit mund të marrë pjesë media dhe çdokush tjetër. Unë nuk e di se si mund te bëjmë më mirë nga ana e infrastrukturës. A do ketë probleme? Edhe mund të ketë, në dorën tonë është për t'i minimizojmë këto probleme.

- Rrok Marku: Këtu ku janë ndarë lagjet janë me emra fisesh, por propozoj të fitojë ata për ndodhen në territorin e kësaj lagjeje, sepse ka ndodh për kanë shkuar të votojnë e janë përjashtuar nga votimi, pra të votojnë.
- Agostin Marku: Pikërisht sepse ka pasur probleme të tilla ne e kemi specifikuar në projekt vendim, në pikën 1 (citon pikën 1).
- Donike Ndoj: Është shumë e rëndësishme për këto zgjedhje mos të jenë të orientuara por të jenë të lira, pra jo si preferencë e ndonjërit prej këshilltarëve. sepse nëpër lagje dihen njerëzit me reputacion prandaj është shumë e rëndësishme t'u japim shansë të barabarta të fitojnë atyre për duan të drejtojnë fshatin. Dhe roli i administratorëve mos të jetë ndikues, pra të jenë zgjedhje të lira.

Ndue Luli: Nëse ne do jemi në pozitë të duhura si këshilltarë, atëherë këto zgjedhje do të shkojnë

Si duhet, në zbatim të rregullores.
Fjalën tani e ka zv/kryetari në lidhje me komisionet sepse ka një ndryshim të vogël.
- Agostin Marku: Në një rakordancë përfundimtare të mazhorancës, pjesës së pozitës, në Blinisht në vend të Anton Ndrecit të jetë Klejvi Hoxhiqi, në Ungrej në vend të Klejvi Hoxhiqit të jetë Marko Jaku, në Shënkoll në vend të Marko Jakut të jetë Anton Ndreu.
- Ndue Luli: Me këto ndryshime kush është dakord për miratimin e këtij projekt vendimi?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç këshilltares Alfride Marku që votoi kundër.
Kemi një projekt vendim "Për dhënie Certifikatë Mirënjohje z. Sami Hoxha". Se për dijeni është një propozim që vjen nga gjimnazi "Hydajet Lezha" për ish-drejtorin e gjimnazit "Zenel Hajdini" në Gjilan të Kosovës. Dy gjimnazet kanë patur binjakëzim. Meritat e këtij drejtorit kanë qenë që jo vetëm ka qenë një nga kryesuesit e fillimit të këtij binjakëzimi por me maturantët e këtij gjimnazi ka ndikuar edhe te rritja e turizmit në Lezhë, në përhapjen e kulturës ndërmjet nxënësve të dy gjimnazeve, po kështu dhe në fushën e diskutimeve mes dy stafeve sa i përket mësimdhënies, mësimnxënies. Prandaj ne e paraqesim këtë p/vendim para këshillit sot. Kush është dakord për dhënien e

kësaj çertifikate mirënjohje?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezent.
Në fund të rendit të ditës është për njohje Raport mbi zbatimin e Buxhetit për 7-mujorin e vitit 2023.
Pikat e rendit të ditës këto ishin. Ju falenderoj për diskutimet e mendimet.
Kalojmë te pika "Të ndryshme".
Rregullorja e këshillit Bashkiak me publikun dhe me median në nenin 38 "Pjesëmarrja e qytetarëve në mbledhjet e këshillit" (citon fjalë për fjalë nenin).
Jam i sigurtë se secili nga ne i ka të kujtuara këto pika dhe ju keni të drejtën tani për pikën "Të ndryshme".

- Kryetari i dha fjalën znj. Marku me kërkesë të saj.
- Alfrida Marku: Unë jam shumë dakord që ishte shumë i qartë, sepse bëre të qartë se si përfshihet një qytetar që bën kërkesë këtu në këshill për të trajtuar një çështje të veçantë, për njoftimin e strukturave të posaçme por në pikat 7, 8 e në vijim ju keni shumë të qartë se si qytetarët që vijnë për të dëgjuar mbledhjet e këshillit, kanë të drejtën të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit, pra ka dy raste, qytetar që bën kërkesë për të shtruar një çështje në mbledhjen e Këshillit si dhe ka qytetar që vjen me vullnetin të tij për të dëgjuar një mbledhje të këshillit. Këtë nuk keni kuptuar dhe ata që ju sot i refuzuat dhe i penguat, në bazë të ligjit "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe rregullores që vetë e lexove kishin gjithë të drejtën

Kam edhe 3 çështje për t'i shtruar shkurtimisht te pika "Të ndryshme". Sipas nenit 54 të rregullores kërkoj vëmendjen e drejtuesve të këshillit, është here e fundit që në mbledhje nuk procedohet me procesverbal. Sipas nenit 54 mbledhjen regjistrohen audio dhe pasqyrohen në procesverbal dhe nënshkruhen nga pjesëmarrësit. E dyta, është një situatë shumë problematike që po cënon përditshmërinë e banorëve të Lethës, në lidhje me fabrikën e përpunimit të nënprodukteve shtazore, ka një emërtesë shumë të gjatë në QKB, që i shpetëton banorët jo vetëm me aromat që çliron në mjedis por edhe me ndotjen ekstreme duke u bërë shkak për marrjen e sëmundjeve të ndryshme.
I drejtohem drejtuesve të bashkisë, si një ndër kompetencat që ka bashkia që merr përgjegjësi për çështjet mjedisore, për ep tagër se ka në këtë rast, sepse është dhe Ministria e Mjedisit dhe AKM, të marrë masat në respekt të mjedisit dhe të banorëve ose të pezullohet aktiviteti.
Një tjetër çështje është zvarritja fa shkolla e urës së logjes Skënderbeg. Ka pasur një fond të miratuar. Situata është në tejkalim të të gjitha afateve. (I përsërit)

- Ndue Luli: Jemi dhe online – Të tregojmë pak respekt për kolegët, të mos i përsërisim gjërat nga 2-3 herë. Problemet që ngritët janë shumë të drejta në raport me komunitetin.
Kush ka diçka tjetër.

- Ermal Pacaj: Ku është tejkalimi i afateve? Nuk mund të rihet këtu me muhabete të klubit. Është nonsens komplet.

Nuk e pengon askush asnjërit prej këshilltarëve që të thërrasë kryetarit, zv/kryetarin e bashkisë për të dhënë llogari për 1, 2, 3, 4 pika. Jo të vimë këtu dhe kajde po bëjmë muhabet. Duhet me folë me përgjegjësi.

- Ndue Luli: Z. Troshaj e ka fjalën.
- Alfons Troshaj: z. nënkryetar i bashkisë, në Nj. A. Zejmen, llojshmëri i ri që po bëhet - kërkoj informacion se çfarë po bëhet. Pora shtrëllës së Zejmenit dhe në vende të tjera ka bame që janë jashtë standartit. Unë i jam drejtuar drejtorit të Taksave si me email, si me shkresë zyrtare. Sa biznese ka Nj. A. Zejmen? Sa tatimpagues janë në këtë zonë? Mua më kanë ardhur shumë taksa që nuk më shërben bashkia. Unë dua të di sa % e bizneseve paguajnë.
- Ermal Pacaj: Po e filloj nga fundi. Sa i përket pjesës së taksave, ka biznese informale. Ka një shumëfishim të njëjës së taksës së fjetjes në hotel në bregdetin e Lezhës krahasuar me vitin 2019. Informaliteti ka pasur sa të duash. Lufta me informalitetin nuk ndalet asnjëherë. Sa i përket taksave që ju thoni se janë shumë të larta, Paketa Fiskale shumë shpejt këtu në këshill do vijë, do e diskutojmë. Hapi i parë që kemi ndërmarrë ne ka qenë ulja e taksave, gjë e cila ka dhënë rezultat se ka ndikuar në zgjerimin e bazës. Por ka raste specifike që duhen parë. Problemi i bamave është problemi historik që ndodh në rrugët tona. Rruga e Zejmenit është rrugë nacionale, pra Bashkia

e Lezhës nuk është autoritet për këtë. Në lidhje me ngjyshmërit, me dijeninë që unë kam, aty ka pasur probleme ndërtuese

- Emanuel Përjaku: Z. nënkryetar, nuk na ktheyet përgjigje se çfarë masash janë marrë për fabrikën e zorrëve. Kanë shkuar shumë ankesa me firma të banorëve se lejen e zhvillimit bashkia ia ka dhënë si rregull.
- Ermal Pacaj: Në cil vit e ka marrë lejen?
- Emanuel Përjaku: Ti duhet ta dish më mirë besoj
- Ermal Pacaj: Bashkia e Lezhës është njohur me problematikën, ka marrë dhe ankesat dhe kemi bërë gjithë korespondencën që duhet me Ministrinë e Mjedisit, me të gjitha institucionet kompetente. Bashkia Lezhë nuk është kompetente, nuk është autoriteti.
- Donika Haxhia: Kryet shkurt. Do doja që kur flasim mos të shihemi si opozitarë. Këtu duhet të mbështesim njëri-tjetrin kur bëhet fjalë për të mirën e qytetarëve. Po të flasim për atë fabrikë, ajo është një tmerr. Ne e dimë që jo mbi gjithçka bashkia ka autoritet. por ju jeni zgjedhur për të bërë ndërmjetësin me ato struktura që kanë autoritet. Kur ti diçka e bën mirë, të japë dorën. Nuk jemi armiq këtu. Unë jam e bindur, që një vend të bëhet, duhet ta duam fort atë.

Flutura Gjoni: Te njoftimi citoni rregulloren-vendimin, por nuk citoni vendimin që kemi marrë ne. E dyta, një rregullore për qytetarët cila rregullore

është sepse kjo rregullore që citova unë, në nenin 57 thotë që anëtarët e këshillit të bashkisë janë të lirë dhe mund të marrë kushdo pjesë në to. (e citon shprehimisht më pas). Pika 9 u kalua.

- Ermal Pacaj: A mund të them vetëm diçka në lidhje me pretendimin që ka zysha (Znj. Hoxhia) - ka të drejtë dhe të falenderoj që e shtron jo në planin politik. E dyta - Me lejen tuaj a mund të largohemi sepse nga kërkesa që na ka ardhë, nuk na kemi sjellë diçka tjetër. Kthyem përgjigje, paraprakisht se nuk ishim të informuar për përgjigjet që do kthenim se duhet të vijë drejtori kompetent se është më bindës se unë. Ju falenderoj. Punë të mbarë.

- Ndue Lumi: Se i përket pikës 9. Është një raport i cili është për njohje, jo për vendimmarrje. Unë të pranoj me shumë ndërgjegje që n.q.s. ka ndonjë problem, ta ngresh tani; dhe te pika "Të ndryshme".

- Rajmonda Prendaj: Znj. Donika unë nuk kam asgjë personale me asnjëri, çdo vendim që është për të mirën e komunitetit, jam pro edhe unë ashtu si ti. Familje që jetojnë aty afër fabrikës me kemë komunikuar, që nuk mund të hapin dritaren, nuk mund të jetojnë, nuk mund të rrinë. Ajo që them unë, është se ku kemi qenë jo para 4 vitesh se ajo fabrikë nuk është ndërtuar as para 2 vitesh, as para 3 vitesh.

- Ndue Luli: Fjalën e ka Z. Jaku.
- Tonin Jaku: Para 2 javëve është dëmtuar dera e rezervuarit në Pllanë. Është lajmëruar bashkia, policia, njësia Zejmen dhe nuk është marrë asnjë masë. Është thyer, është dëmtuar me forcë. Tjetër, nga shkolla e Zejmenit deri te komuna e Kolshit gjënë ka bume. N.p.s bënim 20 minuta për të ardhur në Lezhë, sot bëjmë 1 orë.
- Ndue Luli: Do ia transmetojmë bashkisë shqetësimin për thatë.

Ju falenderoj.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mbledhja u transmetua live në Facebook, në faqen "Këshilli i Bashkisë Lezhë".

SEKRETARI
FLORIDA GJUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI